



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 306 Prot.

Tiranë, më 02/ 04/ 2015

Lënda : Dërgohet rekomandim për ndryshimin e Ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” me qëllim eleminimin e dispozitave që sjellin pasoja diskriminuese për shkak të gjinisë.

Drejtuar : **Z. Saimir TAHIRI**
MINISTËR
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

TIRANË

Për dijeni: **Znj. Aurela ANASTASI**
Drejtore Ekzekutive
QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE

TIRANË

Inderuar zoti Ministër,

Pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), i cili në bazë të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është institucion i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo sjellje që nxit diskriminimin, ka paraqitur një ankesë organizata jofitimprurëse Qëndra për Nisma Ligjore Qytetare.(QNL)

Kjo organizatë jofitimprurëse ka parashtruar para KMD-së se gjatë aktivitet që ajo ushtron në mbështetjen, ndihmën dhe edukimin e shtetasve, me përparësi gratë dhe vajzat me qëllim rritjen e aksesit të tyre në sistemin e drejtësisë, ka indetifikuar një rast ku si rezultat i zbatimit të ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” dhe konkretisht i neneve 16 dhe 17 të këtij ligji, ka



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Katë II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

ardhur si pasojë diskriminimi për shkak të gjinisë, gjëndjes familjare dhe martesore. QNL parashtron se shkak është bërë formulimi i pasaktë dhe i paplotë i neneve 16 dhe 17 të këtij ligji, të cilët parashikojnë të drejtën e kryefamiljarit për të deklaruar ndryshimin e vendbanimit të familjes së tij, dhe në mënyrën se si janë hartuar këto dispozita dëshmojnë se nuk janë të afta që të sigurojnë në praktikë deklarimin e vullnetit të përbashkët të bashkëshortëve, duke lejuar transferimin e vendbanimit dhe të gjëndjes civile mbi bazën e vullnetit të njëanshëm të bashkëshortit. Në këtë mënyrë gjatë ofrimit të shërbimit për kryerjen e transferimit të vendbanimit, zyra e gjendjes civile mund të kryejë sjellje diskriminuese për shkak se ajo mbështetet vetëm në deklarimin e njëanshëm të njëjrit prej bashkëshortëve, ndonëse është duke vepruar në bazë të ligjit “*Për gjendjen civile*”. Ndryshimi i vendbanimit sjell një sërë pasojash juridike, sikurse në rastin konkret të identifikuar nga QNL. Për shkak të ndryshimit të vendbanimit nga bashkëshorti që ishte në cilësinë e kryefamiljarit, pa qënë në dijeni bashkëshortja, erdhën pasoja në kompetencën tokësore të gjykatës që do të shqyrtonë çështjen e zgjidhjes së martesës midis bashkëshortëve.

Sa më sipër, nenet 16 dhe 17 të ligjit “*Për gjendjen civile*” si dhe praktika e tij bie ndesh me Kushtetutën e RSH dhe konkretisht nenet 18 dhe 38 të saj, Konventën mbi Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe konkretisht neneve 15, pika 4, si dhe janë shkelur neni 1, neni 3/2, neni 20/a, b, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, si dhe nenet 4, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9970 datë 24.07.2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*”

Bazuar në ligjin “*Për Mbrotjen nga Diskriminimi*”, në analizë të legjislacionit kombëtar në fuqi dhe atij ndërkombëtar të ratifikuar nga vendi ynë, dhe sa ka parashtruar në informacionin e dërguar nga ana e QNL, Komisioneri, arrin në konkluzionin se nenet 16 dhe 17 të ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 “*Për gjendjen civile*” vijnë në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit. Për këtë arsy e praktika që ndiqet nga zyrat e gjendjes civile në rastet e ndryshimit të vendbanimit, sipas neneve 16 e 17 të këtij ligji, sjell si pasojë diskriminim të tertiortë për shkak të gjinisë. Ky konkluzion i arritur nga ana e KMD bazohet në arsyetimin e mëposhtëm:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që është akti me fuqinë më të lartë në Republikën e Shqipërisë, sanksionon se: **“Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirish në çdo pjesë të territorit të shtetit”**¹ dhe se: **“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha,**

¹ Neni 38 i Kushtetutës



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatesia prindërore.”² Shqipëria ka ratifikuar që prej vitit 1993 Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”, me ligjin me Ligjin 7767 datë 09.11.1993, duke e bërë këtë Konventë pjesë të legjislacionit tonë komëtar. Me pranimin e Konventës shtetet palë mund të zbatojnë ligjërisht këto parime në praktikë. Ato janë të detyruara të marrin një sërë masash për të ndaluar diskriminimin ndaj gruas në të gjitha format, duke përfshirë ndër të tjera, parimet e barazisë gjinore në sistemin ligjor vendas, nëpërmjet shfuzizimit të legjislacionit diskriminues, apo hartimit të ligjeve që luftojnë diskriminimin gjinor dhe duke hartuar dhe zbatuar politika të ndjeshme për gratë. I lidhur me çështjen konkrete është nen 15, paragrafi 4 i Konventës i cili parashikon se: “*Shtetet palë do t'u njojin burrit edhe gruas të drejta të njëjta lidhur me legjislacionin që trajton të drejtën e personave për të lëvizur lirisht, si dhe për të zgjedhur vendbanimin dhe banesën e tyre*”.

Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 21 (sesioni i 13-të, 1994) “*Barazia në martesë dhe marrëdhëni familjare*”, i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, në pikën 3, të tij thekson se : “*Konventa për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave rikujton të drejtat e patjetërsueshme të gruas që janë të mishëruar tashmë në konventat dhe deklaratat e lartpërmendura, por ajo shkon më tej duke njojur rëndësinë e kulturës dhe traditës në formësimin e të menduarit dhe sjelljes së burrave dhe grave dhe rolin e rëndësishëm që ata të luajnë në kufizimin e ushtrimit të të drejtave bazë nga gruaja.*”

Po në këtë rekomandim, i cili në përbajtjen e vet trajton 3 nene të konventës dhe konkretisht nenet, 9, 15 dhe 16, të cilat sipas Komitetit kanë një rëndësi të veçantë për statusin e gruas në familje, në pikën 7, parashikon : “*Vendbanimi është një koncept në vendet common law, që i referohet vendit në të cilin një person synon të banojë dhe juridiksonit të së cilit i nënshtrohet. Vendbanimi fillimisht përfshohet nga një fëmijë nëpërmjet prindërvë të tij, por, në moshën e rritur, tregon vendin në të cilin një person banon normalisht dhe në të cilin ajo synon të banojë në mënyrë të përhershme. Ashtu si në rastin e kombësisë, shqyrtimi i raporteve të Shteteve palë demonstron se një grua nuk i lejohet gjithmonë nga ligji që të zgjedhë vendbanimin e saj. Vendbanimi, si kombësia, duhet të jetë i aftë të ndërrohet sipas dëshirës nga një grua të rritur pavarësisht nga statusi i saj martesor. Çfarëdo kufizimi në të drejtën e një gruaje për të zgjedhur një vendbanim të përhershëm në të njëjtat kushte me një burrë mund të kufizojnë aksesin e saj në gjykatat e vendit në të cilin ajo jeton ose e ndalon atë që të hyjë dhe dalë lirisht një vend dhe në të drejtën e saj.*”

² Neni 18, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës



Adresa: Rrugë Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

Gjithashtu që prej viti 2004, vendi ynë ka miratuar një ligj për barazinë gjinore në shoqëri, dhe konkretisht Ligji nr.9198, datë 1.7.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i cili është zëvendësuar nga Ligji nr. 9970 dt. 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i cili është aktualisht në fuqi. Ky ligj përcakton se diskriminimi për shkak të gjinisë është i ndaluar. Në nenin 6, pika 2, të këtij ligji përcaktohet se: “.....2. Hartimi, zbatimi, nxitja dhe krijimi i dispozitave, kushteve, kritereve apo praktikave, në dukje neutrale, por që sjellin vendosjen në një situatë më pak të favorshme të një personi të njërsës gjini, krahasuar me personat e gjinisë tjetër, përbën diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. Nga ky ndalim bëjnë përjashtim rastet kur këto dispozita, kushte, kriter apo praktika justifikohen nga një qëllim i përligjur dhe mjetet apo rrugët për arritjen e këtij qëllimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme.”

Gjithashtu, ligji “Për barazi gjinore në shoqëri”, parashikon në nenin 7 se, për sigurimin e barazisë gjinore dhe eleminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, organet shetërore në bazë të kompetencave të tyre, duhet ndër të tjera që përmes masave legislative, por edhe masave të tjera të përshtatshme duhet të ndryshojnë ose shfuqizojnë çdo ligj, zakon apo praktikë që përbën diskriminim për shkak të gjinisë, dhe duhet të marrin të gjitha masat e përshtatshme, për të krijuar lehtësitet e nevojshme e të përligjura objektivisht, për mundësi të barabarta dhe akses të barabartë për të dyja gjinjtë.

Në mbështetje të nenit 18 të Kushtetutës, është miratuar ligji nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, ku ndër të tjera edhe gjininë.

Në nenin 3, pika 3, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcaktohet se: “ *kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter apo praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë, përbën diskriminim, dhe pikërisht atë formë diskriminimi që ligji e përkufizon si "Diskriminim i tërthortë".*

Në nenin 20, pika1, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “*1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të*



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin I të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Në nenin 16 dhe 17 të ligjit “Për gjendjen civile” parashikohet sa më poshtë:

Neni 16, i cili parashikon të drejtën për deklarimin e vendbanimit, sanksionon: “*1. Deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes. 2. Çdo person madhor, që vendos të jetojë në një vendbanim të ndryshëm nga ai i pjesëtarëve të tjerë të familjes, bën deklarim individual të vendbanimit. Shtetas mund të deklarojë, gjithashtu, në mënyrë individuale një banesë për përdorim vetjak.....”*

Neni 17, i cili parashikon të drejtën për t'u pranuar në një vendbanim tjetër, sanksionon: “*1. Një shtetas apo një familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një shtetas apo familjeje tjetër, kur plotësohen standardet e sipërfaqes së banimit përfrymë, sipas legjisacionit në fuqi, si dhe kur zotërojnë një kontratë apo kur kryefamiljari i familjes pritëse apo shtetas që zotëron titull të ligjshëm pronësie ose përdorimi të banesës, deklaron në zyrën e gjendjes civile pranimin e shtetasit apo familjes ardhëse në atë vendbanim.*”

Në pamje të parë, këto dy nene nuk kanë nuanca gjinore dhe duken neutrale, për më tëpër nga fakti se ligji edhe pse përdor në këto dy nene konceptin “Kryefamiljar”, në asnjë prej dispozitiveve të tij nuk ka dhënë përkufizimin për këtë term, pra nuk ka shpjeguar se çfarë duhet kuptuar me këtë term, edhe pse në këto dy nene i ka veshur personit që gjëzon cilësinë e “Kryefamiljarit” të drejtën për të deklaruar vendbanimin.

Vendbanimi si një nga elementët përbërës të gjendjes civile të një shtetas, passjell për të një sërë pasojash juridike. Në rastin e sjellë nga QNL, ka përcaktuar kompetencën tokësore të gjykatës që do të shyrtonë çështjen gjyqësore për zgjidhjen e martesës midis bashkëshortëve. Në realitet vendbanimi është i lidhur me një sërë të drejtash dhe detyrimesh që lindin për individin nga legjisacioni në fuqi si çështja e ushtrimit të së drejtës së votës, përfitimet e ndryshme nga skemat e mbrojtjes sociale, etj.

Neutralitet në dukje të krijon veçanërisht edhe pika e dytë e nenit 16, ku përcakton se çdo person madhor mundet që lirisht të deklarojë një vendbanim të ndryshëm nga anëtarët e tjerë të familjes,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

por përtej këtij neutraliteti, ligji “*Për gjëndjen civile*” nuk ka mbajtur parasysh statusin e veçantë të bashkëshortëve dhe detyrimit që atyre ju lind në bazë të Kodit të Familjes, dhe konkretisht nenit 55, i cili parashikon se : “*Bashkëshortët kanë detyrimin e jetesës së përbashkët. Vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët. Në rast mosmarrëveshjeje, secili nga bashkëshortët mund t'i drejtohet gjykatës,.....*”

Por, ndryshe nga Kodi i Familjes, i cili ka theksuar se vendbanimi i bashkëshortëve përcaktohet me marrëveshje të përbashkët, pra duke marrë për bazë pëlqimin e të dy bashkëshortëve, neni 16 i ligjit “*Për gjendjen civile*” nuk garanton marrjen e vullnetit të të dy bashkëshortëve në përcaktimin e vendbanimit të bashkëshortëve. Kjo vjen pasi i jepet e drejta e deklarimit të vendbanimit një anëtari të familjes që ka statusin e “Kryefamiljari”, por pa dhënë një përkufizim të këtij termi. Por, përtej këtij fakti, duke qënë se familja ka si vendbanim atë të zgjedhur bashkarisht nga bashkëshortët, atëherë edhe koncepti i “Kryefamiljarit” si një individ i vetëm do të ishte i papërshtatshëm për të garantuar marrjen e pëlqimit të të dy bashkëshortëve, siç kërkohet nga Kodi Familjar, i cili në bazë të hierarkisë së normave dhe si një ligj i miratuar me një shumicë të cilësuar, qëndron mbi ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë siç është ligji “*Për gjëndjen civile*”.

Sa më sipër, japid qartë rëndësinë që ka vendbanimi në gjëzimin e të drejtave dhe lirive të një personi, por njëkohësisht del në pah edhe fakti se rregullimi që është bërë me nenet 16 dhe 17 të ligjit “*Për gjëndjen Civile*” nuk është në përputhje me rregullimin që bën Kodi i Familjes për vendbanimin e bashkëshortëve, pasi nuk garanton marrjen e vullnetit të përbashkët të bashkëshortëve në zgjedhjen e vendbanimit.

Por, përtej, mospërputhjes së këtyre dy neneve me parashikimet e Kodit të Familjes, KMD konstaton se praktika që rrjedh nga zbatimi i neneve 16 dhe 17 të ligjit “*Për gjëndjen civile*”, rezulton që i vendos gratë në pozita jo të favorshme në krahasim me burrat, pra efektet që vijnë në praktikë janë më pak të favorshme për gratë sesa për burrat. Këto nene të paanshme në dukje, në zbatimin e tyre në praktikë sjellin efekte të ndryshme tek secila gjini, dhe konkterisht pasoja më pak të favoshme për gratë sesa për burrat.

Në kushtet kur ligji nuk ka vendosur ndonjë kufizim gjinor për të qënë kryefamiljar, atëherë pse shprehemi se pasojat jo të favorshme rëndojnë mbi gratë dhe jo mbi burrat. Në bazë të ligjit në fuqi, gratë në parim kanë të njëjtat mundësi për të qënë kryefamiljare si burrat. Në parim po, por a rezulton edhe në praktikë e njëjtë gje? Përgjigja në këtë rast do të ishte, jo.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Nga praktika e saj në ofrimin e shërbimeve ligjore për gratë dhe vajzat, QNL shprehet se ju ka rezultuar se në përqindjen më të lartë të rasteve, në cilësinë e kryefamiljarit ka rezultuar bashkëshorti. Bashkëshortja bëhet kryefamiljare vetëm në rastet kur ajo mbetet nënë e vetme.

Në realitetin shqiptar është një fakt i pamohueshëm që burri konsiderohet si i pari i familjes dhe se gruaja shihet në shumicën dërrmuese të rasteve në funksion të burrit dhe ka një pozicion dytësor. Në shoqërinë shqiptare burrat, janë individët që veprojnë me cilësinë e kryefamiljarëve, duke kufizuar në këtë mënyrë në shumë aspekte të jetës gruan. Si kryefamiljar burri bën aplikimin pranë Aluizni-t, si kryefamiljar prona regjistrohet në emër të tij, në traditën shqiptare edhe pse legjislacioni garanton barazi të plotë midis vajzës dhe djalit, prindërit shohin djalin si trashëgimtar të pasurive dhe mirëqënies së familjes. Stereotipet dhe paragjykimet që vijnë nga tradita dhe zakonet edhe pse në shumë raste ligjet dhe aktet nënligjore në Shqipëri kanë qënë neutrale nga pikëpamja gjinore, për shkak të mendësive dhe formësimit të individëve, sjellin si rezultat vendosjen në pozita më pak të favorshme të grave në krahasim me burrat.

Ka shumë shembuj të deklaratave në dokumentet e OKB-së, të cilat shprehin se, kultura, tradita apo feja nuk mund të përdoren për të justifikuar shkeljet e të drejtave të grave, apo që shtetet kanë detyrimin për të kundërshtuar shkeljet kundër grave në bazë të kulturës, traditës apo fesë.

Në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, një gjë të tillë e gjejmë në nenin 5/a ku përcaktohet : “*Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme: (a) Për të ndryshuar karakteristikat dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes së burrit dhe të gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore, dhe të gjitha praktikat e tjera që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit apo të tjetrit seks, ose në rolet stereotipe të burrit dhe të gruas;.....*”.

Duke njojur rëndësinë e kulturës dhe traditës në formësimin e të menduarit dhe sjelljes së burrave dhe grave dhe rolin e rëndësishëm që ata të luajnë në kufizimin e ushtrimit të të drejtave bazë nga gruaja, siç edhe theksohet në Rekomandimin e Përgjithshëm Nr.21, që citohet më sipër, dhe duke njojur realitetin, kulturën dhe traditën shqiptare, arrijmë në përfundimin se realisht nenet 16 dhe 17 të ligjit “*Për gjendjen Civile*” edhe pse në dukje neutrale sjellin pasoja më pak të favorshme për gratë në raport me burrat, duke i diskriminuar gratë në mënyrë të tertiortë.

Në fryshtë e Konventës dhe të detyrimeve që ajo vendos në drejtim të luftës kundër stereotipeve dhe paragjykimeve me natyrë gjinore, rëndësi të veçantë në drejtim të arritjes së barazisë gjinore në shoqëri ka vendosur edhe Ligji “*Për barazinë gjinore në shoqëri*” i cili për sigurimin e barazisë gjinore dhe eleminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, ngarkon organet shëtërore



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

sipas kompetencave të tyre, që përmes masave legislative, por edhe masave të tjera të përshtatshme, për të krijuar lehtësitë e nevojshme e të përligjura objektivisht, për mundësi të barabarta dhe akses të barabartë për të dyja gjinjtë.

Sa më sipër, KMD, arrin në konkluzionin se nen 16 dhe 17 i ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” diskriminojnë në mënyrë të tèrthortë gratë, për shkak të gjinisë dhe praktika që ndiqet nga zyrat e gjendjes civile në zbatim të këtyre dispozitave sjell pasoja diskriminuese pér gratë, duke mos ofruar shërbimet e përcaktuara nga ligji në baza të barabarta me burrat.


Bazuar në Ligjin nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Pér Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 3, pika 3, nen 20, pika 1 dhe në bazë të kompetencave të Komisionerit të përcaktuara në nen 32, pika 1, gërmë “ë”, ku parashikohet se: “*1. Komisioneri ka kompetencë:ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjisacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjisacionit ekzistues;.....*”, Komisioneri pér Mbrojtjen nga Diskriminimi,

RE KOMANDON

1. Rishikimin e neneve 16 dhe 17 të ligjit nr. 10 129 datë 11.05.2009 “Pér gjendjen civile”, në lidhje me konceptin e “Kryefamiljarit” dhe të detyrave të parashikuara nga ligji pér të garantuar që në procedurat e deklarimit të vendbanimit të merret pëlgimi i të dy bashkëshortëve.
2. Deri në ndryshimin e legjisacionit, të merren masat përkatëse me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese, duke ndryshuar praktikën e zyrave të gjendjes civile në zbatim të nenit 16 dhe 17 të ligjit nr. 10 129 datë 11.05.2009 “Pér gjendjen civile”, pér të bërë të mundur tèrheqjen e mendimit të dy bashkëshortëve pér ndryshimin e vendbanimit.

Ju lutemi të na informoni brenda një afati të arsyeshëm lidhur me masat e marra pér zbatimin e këtij rekomandimi.

Duke Ju falenderuar pér bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Katë II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al